



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.1,
Korrik 2017

NDIKIMI I BORDIT DREJTUES NË PERFORMANCËN E SISTEMIT BANKAR

Joana Shima

Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit, Universiteti European i Tiranës, Tiranë

Adresë kontakti: joana.shima@uet.edu.al

Përmbledhje

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, çështja e qeverisjes së korporatave është bërë gjithnjë e më e rëndësishme. Gjatë kësaj periudhe, shumë kriza financiare kanë nxjerrë në pah si një prej shkaqeve kryesore qeverisjen e dobët të korporatave. Ajo mbulon disiplina të ndryshme, përfshirë financën, kontabilitetin, ligjin dhe jurisprudencën, menaxhimin, etikën e biznesit dhe politikëbërjen. Çdo krizë ka ngritur shqetësime mbi elemente të veçanta të qeverisjes së korporatave.

Në literaturë, ekzistojnë qasje të ndryshme teorike për shpjegimin e qeverisjes së korporatave, të cilat përdorin terminologji dhe teknika të ndryshme. Këto qasje burojnë nga sisteme specifike ekonomike, sociale dhe ligjore, si dhe nga sfonde të ndryshme historike. Teoritë kryesore, njëkohësisht më të debatuarat, janë teoria e agjencisë dhe teoria e aktorëve [1]. Në kontrast me literaturën relativisht të pasur për qeverisjen e korporatave në përgjithësi, deri në krizën e fundit financiare të viteve 2007-2009, qeverisjes së korporatave në banka i është kushtuar pak vëmendje nga akademikët. Si një prej shkaqeve të dështimit të bankave, kriza identifikoi ndër të tjera edhe qeverisjen e dobët të korporatave.

Fjalë çelës: *qeverisje korporate, bord drejtues, performancë, teoria e agjencisë, teoria e aktorëve.*

IMPACT OF THE STEERING BOARD IN THE PERFORMANCE OF THE BANKING SYSTEM

Abstract

Over the past decades, the issue of corporate governance has become increasingly important. During this period, many financial crises have highlighted one of the major causes of weak corporate governance. It covers various disciplines, including finance, accounting, law and jurisprudence, management, business ethics, and policy making. Every crisis has raised concerns about the particular elements of corporate governance.

In the literature, there are various theoretical approaches to corporate governance explanation, which use different terminology and techniques. These approaches stem from specific economic, social and legal systems as well as various historical backgrounds. The main

theories - at the same time the most controversial - are agency theory and actor's theory [1]. In contrast to the relatively wealthy literature on corporate governance in general, until the recent financial crisis of 2007-2009, little attention has been paid to corporate governance in banks by academics. As one of the causes of bank failure, the crisis identified, among other things, poor corporate governance.

Key words: *Corporate Governance, Governing Board, Performance, Agency Theory, Theory of Actors.*

Hyrje

Problemet e qeverisjes së korporatave ekzistojnë në të gjitha vendet, pavarësisht sistemit apo shkallës së zhvillimit të tyre. Megjithatë, në vendet në tranzicion, çështjet e qeverisjes së korporatave marrin rëndësi të veçantë. Në vendet post-komuniste pasojat e centralizimit të ekonomisë dhe të jetës sociale duket se janë pengesa serioze për një qeverisje solide të korporatave.

Një prej karakteristikave të përbashkëta të këtyre vendeve janë tregjet e pazhvilluara financiare, çfarë i bën bankat burimin kryesor të financimit dhe u jep rol kryesor për rritjen ekonomike [2]. Një argument mund të ishte se bankat mund ta kenë marrë këtë rol falë zgjedhjes së vendeve për të përqaftuar modelin e “ndikimit të brendshëm” të qeverisjes së korporatave, me dizenjimin e sistemeve të tyre të reja ligjore dhe ekonomike, gjatë periudhës së tranzicionit. Ndonëse argumenti i modelit të “ndikimit të brendshëm” në raste të veçanta ka të ngjarë të qëndrojë, ne mendojmë se faza e zhvillimit të tregjeve të kapitalit dhe forcimi i rolit të veçantë të bankave në këto vende është ndikuar më shumë nga sfidat e tranzicionit me të cilat janë përballur.

Në një studim mbi qeverisjen e korporatave në vendet e Evropës Juglindore (EJL), OECD-ja [3] identifikon kapacitetet e dobëta të sistemit gjyqësor në vendet e EJL-së si një nga pengesat kryesore për një qeverisje të efektshme të korporatave. Ndonëse reformat ligjore kanë sjellë akte ligjore të standardeve të larta, sistemet gjyqësore në këto vende janë gjendur të papërgatitura për shkak të mungesës së përvojës, mungesës së trajnimit të vazhdueshëm dhe burimeve të pamjaftueshme. Në të vërtetë, ekspertiza, profesionalizmi dhe burimet e pamjaftueshme, ndërthurur me një nivel të lartë korrupsioni dhe me mungesën e pavarësisë të pushtetit gjyqësor, i përkeqësojnë më tej rezultatet negative të mungesës së “Sundimit të së Drejtës” [4].

Mungesa e tregjeve financiare sjell një sërë rezultatesh, ndër të cilat, veçohen si më të rëndësishmet dhe të drejtpërdrejta: numri i ulët i menaxherëve me ekspertizë në tregun e punës, anëtarë këshilli pa përvojë, ndikim politik në qeverisjen e kompanive me shumicë aksionesh dhe kontroll dominues të shtetit. Vendet që janë në tranzicion shtyjnë drejt një modeli të “ndikimit të brendshëm” të qeverisjes së korporatave, pavarësisht sistemit të dizenuar në përmbajtjen e legjisllacionit (*letter of law*) [5]. Bankat në këto vende duhet të përballen me një gamë të re problemesh të agjencisë, të cilat janë specifike për ekonominë në tranzicion dhe që lindin nga marrëdhënia midis qeverisjes së korporatave dhe rregullimit bankar. Kjo nxjerr në pah domosdoshmërinë për një rol më të fortë të agjencive rregullatore dhe mbikëqyrëse, për arsye se si agjentë të interesit të publikut, që operojnë në një mjedis ku monitorimi i jashtëm privat dhe mekanizmat kontrollues të tregut mungojnë, ato kanë më shumë incentivë se gjyqtarët për zbatimin dhe forcimin e ligjeve dhe akteve nënligjore [3].

Si qeverisja e korporatave, edhe rregullimi bankar, mund të shihen si rezultate të problemeve të agjencisë, të lidhura me ndarjen midis pronësisë dhe kontrollit të përditshëm mbi kompaninë (menaxhimit). Nga kjo pikëpamje, ashtu si në rastin e qeverisjes së korporatave, objekti i rregullimit

bankar është parandalimi i sjelljes abuzive të menaxherëve dhe i vendosjes së interesave të tyre vetjake mbi ato të principalëve, çfarë shkakton lindjen e konfliktit të interesave.

Rishikim literature

Qeverisja e korporatave është një koncept i gjerë që mund të përshkruhet si tërësi e marrëdhënieve midis një institucioni, menaxherëve, aksionerëve dhe aktorëve të tjerë. Qeverisja e brendshme është një pjesë përbërëse më e vogël, por kyçe, e qeverisjes së korporatave, që fokusohet në strukturën e brendshme dhe në organizimin e një institucioni [6]. Ajo mbulon rrjetin e gjerë të sistemeve, proceseve dhe procedurave që kërkojnë të rregullojnë marrëdhënien midis menaxherëve dhe aksionarëve në veçanti, dhe midis aktorëve të firmave në përgjithësi [7]. Për të ruajtur legjitimitetin dhe besueshmërinë në mënyrë efektive, menaxhimi i korporatës duhet të jetë përgjegjës. Një përfaqësues i pavarur, kompetent dhe i motivuar – këto janë cilësitë që bordi i drejtorëve është projektuar të ketë [8]. Katër vlerat etike në vijim mbështeten në qeverisjen e mirë të korporatave: përgjegjësi, llogaridhënie, drejtësi dhe transparencë.

Në përgjigje të krizës financiare globale, Komisioni Evropian publikoi më 3 qershor 2010 një material mbi qeverisjen e korporatave në institucione financiare dhe politikat e shpërblimit, i cili paraqet në vetvete një program për shqyrtimin e qeverisjes së korporatave në institucione financiare. Konteksti i përgjithshëm i qasjes së BE-së ndaj qeverisjes së korporatave në këto institucione është i ngjashëm me atë të Komitetit të Bazelit. Së pari, ai përqendrohet në kuptimin e ngushtë të qeverisjes së korporatave, duke mbuluar vetëm proceset e brendshme të menaxhimit të biznesit të bankave dhe lë jashtë trajtimit aspekte të tjera të rëndësishme, si ndarja e qartë e përgjegjësisë dhe funksioneve. Së dyti, ky dokument (*Green Paper*) përforcon këndvështrimin e mbikëqyrësve për qeverisjen e korporatave, duke theksuar rëndësinë që ka qeverisja e shëndoshë e korporatave në institucione financiare për mbrojtjen e interesave të kreditorëve (depozituesve), së bashku me ato të aksionerëve.

Zhvillimi i tregut financiar botëror është shoqëruar me prirjen drejt konvergimit të sistemeve të qeverisjes së korporatave të vendeve të ndryshme. Në Mbretërinë e Bashkuar dhe në SHBA, institucione të mëdha financiare po kthehen në aksionerë gjithmonë e më të mëdhenj, duke ndryshuar strukturën e shpërndarë të kapitalit të kompanive. Kjo sjell rritjen e monitorimit të sjelljes menaxheriale - veçori kjo dalluese e sistemit të ndikimit të brendshëm [9]. Nga ana tjetër, për kompanitë gjermane, tiparet e modelit të ndikimit të brendshëm duket se janë kthyer në barrierë për gjenerimin e financimit të aktivitetit në tregjet financiare ndërkombëtare. Sipas Solomon [9], reformat e dhjetëvjeçarëve të fundit, si për shembull forcimi dhe përmirësimi i transparencës dhe adoptimi i standardeve ndërkombëtare të pranuarra gjerësisht për qeverisjen e korporatave, kanë çuar në zbehjen e sistemit të ndikimit të brendshëm në Gjermani drejt konvergimit me sistemin e ndikimit të jashtëm.

Dy teoritë kryesore në lidhje me qeverisjen e korporatave janë: teoria e agjencisë dhe teoria e aktorëve të interesuar. Teoria e agjencisë u zhvillua paralelisht me krijimin dhe zhvillimin e tregut të aksioneve, si burim i ri financimi për kompanitë. Para ekzistencës së tregut të aksioneve, kompanitë merrnin financim për aktivitetin e biznesit nga individët, në marrëdhënie familjare që vepronin njëkohësisht si pronarë dhe drejtues të kompanisë. Për shkak të nevojave në rritje për zgjerim të aktivitetit, lindi nevoja për burime të tjera financimi. Kjo solli zhvillimin e tregut të aksioneve si mjet për të mbledhur kapital, duke emetuar aksione për investitorë të rinj të cilët ktheheshin në aksionerë. Tregu i aksioneve ofronte një mundësi jo vetëm për të blerë aksione, por edhe për të gjeneruar të ardhura nga tregtimi i tyre, duke shkaktuar, kështu, ndryshime të shpeshta

të strukturës së pronësisë të kompanisë. Këto zhvillime zunë fill në Mbretërinë e Bashkuar dhe në SHBA [9]. Themelet e teorisë së agjencisë, të referuar në literaturë edhe si “Teoria Principal - Agjent” ose “Vlera e Aksionerit”, bazohen në ndarjen e pronësisë nga kontrolli mbi kompaninë. Sipas kësaj teorie, aksioneri - principali - i delegon menaxherëve – agjentëve drejtimin e kompanisë. Këta të fundit kanë detyrimin për besnikëri ndaj pronarëve, duke njohur e pranuar supremacinë e interesit të aksionerëve - maksimizimin e vlerës së aksioneve - ndaj çdo interesi tjetër [1, 9, 10]. Agjentët, të cilëve u është besuar drejtimi i përditshëm i biznesit, kanë kontrollin real mbi kompaninë, duke krijuar një asimetri midis tyre dhe principalëve. Kjo asimetri është burim për konflikt të interesave ndërmjet principalit dhe agjentit. Shkaku kryesor i këtij problemi ka të bëjë me faktin se menaxherët duke patur më shumë informacion dhe njohuri mbi kompaninë, mund të joshen për të vendosur interesat e tyre, si për shembull bonuse më të larta, mbi interesat e aksionerëve. Ky fenomen njihet në literaturë si “problemi i agjencisë”. Për të parandaluar këtë problem, shpesh bizneset mbartin kostot e agjencisë, të cilat përfshijnë kostot e monitorimit që rëndojnë mbi principalin, kostot lidhëse që rëndojnë mbi agjentin, si dhe kostot që rezultojnë nga reduktimi i mundshëm i vlerës së aksioneve, si pasojë e vendimeve të agjentit, të marra në kundërshtim me interesat e principalit. Pra, teoria e agjencisë bazohet në të drejtën ligjore dhe morale të aksionerëve për të mbikëqyrur kompaninë, mbi të cilën gëzojnë pretendime ligjore në lidhje me flukset e mbetura dhe të drejtat e pronësisë. Vështruar në një nivel tjetër, teoria e aktorëve (*stakeholders theory*) kërkon që menaxherët t’u japin llogari jo vetëm aksionerëve, por edhe aktorëve të tjerë të përfshirë (*stakeholders*). Ky arsytim bazohet në argumentin se, përveç aksionerëve, “interes” mbi kompaninë kanë edhe subjekte të tjera për aq kohë sa ata ndikohen nga veprimtaria e saj. Këta aktorë mund të jenë punonjësit e kompanisë, komuniteti, kreditorët dhe klientët e saj.

Solomon [9] thekson se në disa qasje ekstreme të kësaj teorie, grupi i aktorëve të interesuar mund të përfshijë mjedisin, specie kafshësh, ashtu si dhe brezat e ardhshëm. Megjithatë, kriteri mbizotërues për klasifikimin e aktorëve është steka legjitime e interesit që këto subjekte kanë mbi kompaninë. Kjo teori gjen më shumë zbatim në rastin e kompanive të mëdha, të cilat kanë ndikim të konsiderueshëm jo vetëm mbi një grup të ngushtë të shoqërisë, siç janë aksionerët, por edhe mbi një grup më të gjerë të saj.

Teoria e aktorëve gjen zbatim në vendet perëndimore të Evropës kontinentale, më tradicionalisht në Francë dhe Gjermani, ku punonjësit si aktorë të interesuar kanë një zë të rëndësishëm në drejtimin e kompanisë. Në këto vende, përfaqësuesit e punonjësve janë pjesë e anëtarësisë së këshillit drejtues ose punonjësit zotërojnë aksione të kompanisë. Në këtë mënyrë, ata ndikojnë mbi politikën, strategjitë dhe drejtimin e përditshëm të saj, nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së votës. Teoria e aktorëve duket se është në konflikt me themelet e teorisë së agjencisë. Pyetja kryesore që lind është: “A munden kompanitë që në të njëjtën kohë të kënaqin interesat e aksionerëve duke plotësuar edhe nevojat e aktorëve të tjerë të interesuar”? Sipas teorisë së agjencisë, drejtuesit mund t’i japin llogari një game të gjerë aktorësh, por përgjegjësia e tyre parësore është të përmbushin interesat e aksionerëve [11]. Megjithatë, në dritën e krahasimit cilësor të dy teorive [1], argumenton se edhe në vendet ku teoria e aktorëve është një dimension kyç i të bërit biznes, skandalet financiare kanë qenë të pranishme dhe të shkaktuara nga dështime të ngjashme me ato në Mbretërinë e Bashkuar apo SHBA, vende nga të cilat teoria e agjencisë ka buruar dhe është zhvilluar. Shleifer dhe Vishny [5] në një prej studimeve më të plota për qeverisjen e korporatave, nënvijëzojnë se përqendrimin e pronësisë së kompanive dhe ndikimin i sistemit ligjor duke vënë theksin në nivelin e mbrojtjes ligjore të të drejtave pasurore të investitorëve. Solomon [9] identifikon përqendrimin e pronësisë dhe burimet financiare të kompanisë si kriter më të rëndësishëm, ndërsa Stephen dhe Backhouse

[10] i shohin këto dy modele si “rregullime institucionale me anë të të cilave kontrollohet sjellja menaxheriale”.

Sistemi i ndikimit të jashtëm të qeverisjes së korporatave është formësuar në vende me tregje shumë të zhvilluara të kapitalit. Vendet më përfaqësuese, të këtij sistemi janë Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-ja, ku pronësia e bankave mbi stokun e kapitalit në kompani jo banka në përgjithësi është e ndaluar. Ky sistem njihet si modeli anglo-amerikan apo anglo-sakson, ndërtuar mbi parimin e pronësisë së kompanisë të ndarë nga kontrolli i përditshëm mbi të. Dy efekte kryesore të këtij sistemi janë: përqendrimi i kufizuar i pronësisë, dhe krijimi i një mekanizimi disiplinor për menaxherët bazuar tek stimujt. Ndonëse relativisht pozitiv, efekti i parë i sistemit mund të dekurajojë qeverisjen e shëndoshë të korporatave, meqenëse në rast mosmarrëveshjeje me menaxherët, investitorët mund të parapëlqejnë t’i shesin aksionet sesa të mbartin kosto shtesë nga nxitja e një qeverisjeje më të mirë. Efekti i dytë ka të bëjë me sipërmarrjet armiqësore. Performanca e ulët e menaxherëve në administrimin e kompanisë ndikon në vlerën e tregut të aksioneve, çka josh investitorët e mëdhenj për të blerë kompani duke ushtruar presion mbi to. Qëllimi i këtyre investitorëve është gjenerimi i të ardhurave nga rritja e vlerës së aksioneve të kompanisë në treg nëpërmjet menaxhimit më të mirë të saj [10]. Sistemi i ndikimit të brendshëm karakterizohet nga pronësia e përqendruar dhe kontrolli i ushtruar mbi kompaninë nga një numër i vogël aksionerësh të mëdhenj. Në këto sisteme, kompanitë janë: të zotëruara nga familje që i kanë themeluar ato apo grupe të tjera aksionerësh si qeveritë; kompani të vogla të ndërlidhura me njëra-tjetrën nëpërmjet zotërimit të kryqëzuar të aksioneve (*crossshareholding*) dhe strukturave të pronësisë të formës piramidë [9].

Kirkpatrick [12], i kontraktuar nga OECD-ja, një prej organizatave ndërkombëtare me ndikimin më të madh që studion zhvillimet e qeverisjes së korporatave, identifikoi si dobësi: kërkesat e pamjaftueshme të standardeve rregullatore dhe të kontabilitetit; administrimin e dobët të rrezikut; mosharmonizimin e politikave të remunerimit me strategjinë e institucioneve financiare, oreksin për rrezik, dhe interesat afatgjatë të tyre. Autorë të tjerë vënë theksin në problematika të tjera të qeverisjes së korporatave, të tilla si: sjellja etike dhe veprimet apo mosveprimet oportuniste të këshillit drejtues dhe të menaxhimit të lartë në institucione financiare [9, 13]. Megjithatë, Mulbert [14] dhe Kirkpatrick [12] argumentojnë se nuk ka të dhëna për një kausalitet të drejtpërdrejtë midis dështimeve në qeverisje dhe krizës. Mulbert [14] argumenton se as të dhënat e shumta jozyrtare nuk mund të konsiderohen si provë e fortë për të vërtetuar se shkak kryesor i krizës ishin dështimet në qeverisjen e korporatave. Cianciani dhe Gonzales [15] argumentojnë se si pasojë e rregullimit, problemi i agjencisë në banka është më kompleks. Autorët identifikojnë “tri asimetri të tjera informacioni të bankat: (i) midis depozituesve, bankës dhe rregullatorit; (ii) midis pronarit, menaxherëve dhe rregullatorit; (iii) midis huamarrësve, menaxherëve dhe rregullatorit”. Kjo do të thotë se qeverisja e bankave është substancialisht ndryshe nga qeverisja e korporatave të zakonshme. Roli i rregullatorit mund të shpjegohet si një forcë e jashtme shtesë që ndikon qeverisjen e bankave. Kjo do të thotë se bankat i shërbejnë jo vetëm interesit privat të aksionerëve, por edhe interesit të rregullatorit, i cili vepron si agjent për aktorë të tjerë të interesuar, në këtë rast, për publikun e gjerë. Rrjedhimisht, mund të nxjerrim përfundimin se bankat janë subjekte që i përshtaten më mirë teorisë së aktorëve. Agjentët në një bankë (menaxherët), të cilët janë subjekt i kontrollit nga rregullatori, janë nën presion për të përmbushur nga njëra anë një grup interesash (të principalëve) pa kompromentuar nga ana tjetër interesat e rregullatorit. Ky pozicion i agjentëve të bankave imponon një sjellje të ndryshme menaxheriale nga ajo e agjentëve të kompanive të tjera. Mundësia e rregullatorit për të përdorur instrumentin e huadhënësit të fundit (*lender of last resort*)

do të thotë se pronarët e bankave, në ndryshim nga pronarët e kompanive të tjera, e ndajnë rrezikun me rregullatorin. Siguria që jep ndihma me anë të këtij instrumenti për shpëtim në rast falimentimi, lë hapësirë për krijimin e stimulit për të ndërmarrë rrezik më të madh se sa një kompani normale që nuk e ka këtë mundësi. Ciancianelli dhe Gonzales [15] argumentojnë se meqenëse menaxherët monitorohen si nga këshilli edhe nga aktori mbikëqyrës i jashtëm, mundësia e huadhënësit të fundit, në të vërtetë, nxit aksionerët dhe jo menaxherët, për të ndërmarrë rreziqe më të mëdha. Ashtu si në rastin e huadhënësit të fundit, edhe “sigurimi i depozitave” rrit stimulim e principalëve dhe agjentëve për të ndërmarrë rrezik shtesë. Gjithashtu, sigurimi i depozitave mund të çlirojë depozituesit nga interesi për të monitoruar përdorimin e fondeve të tyre nga bankat. Nga ana tjetër, Mulbert [14] argumenton se ky arsytim, praktikisht, gjen zbatim më shumë për depozituesit e mëdhenj që zotërojnë njohuri dhe ekspertizë mbi rreziqet e bankingut dhe jo atë për depozituesit e vegjël. Konkurrenca e pakufizuar brenda sektorit mund të ketë pasoja të kundërta mbi qëndrueshmërinë/shëndetin e sistemit bankar. Konkurrenca agresive në rastin e sektorit bankar, mund të çojë në shtimin e oreksit si të aksionerëve, ashtu edhe të menaxherëve për të marrë rrezik, përtej pritjeve prudenciale të rregullatorëve/mbikëqyrësve. Qeverisja e shëndetshme luan një rol më të gjerë në rastin e bankave sesa në kompanitë e tjera. Kjo pasi në rastin e bankave ajo u shërben jo vetëm interesave të korporatës, por, duke ofruar mjedisin e duhur për menaxhim të shëndetshëm dhe të kujdesshëm, u shërben edhe interesave të mbikëqyrësve/rregullatorit [16].

Studime të shumta argumentojnë se nuk ka një marrëdhënie sistematike midis profitabilitetit dhe strukturës së pronësisë. Duke marrë parasysh madhësinë e bordit, Adams dhe Mehran [17] vunë në dukje se kompanitë bankare i kanë më të gjera bordet se firmat industriale, për shkak të strukturës së organizuar dhe komplekse. Ata shqyrtojnë marrëdhëniet midis madhësisë së bordit të bankave dhe performancës së tyre, të përafëruara me vlerën e Q-Tobin-it. Në dallim me studimet për kompanitë jofinanciare, ata treguan një marrëdhënie pozitive midis madhësisë së bordit dhe vlerës së Tobinit. Belkhir [18] ka shqyrtuar një marrëdhënie pozitive midis madhësisë së bordit dhe performancës së sistemit bankar. Analiza tregon se kjo marrëdhënie mund të varet nga efektet pozitive të zgjerimit të bankave në përgjigje të rritjes së madhësisë së njëjtë, si një rritje e jashtme që rezulton nga M & A (Mergers & Acquisitions).

Autorë të tjerë kanë gjetur se madhësia e bordit drejtues nuk ka efekt në performancën e bankave. Mayur dhe Saravanan [19], analizuan ndikimin e qeverisjes korporative në ecurinë e bankave, të matur nga vlera Q-Tobin. Rezultatet e punës kanë treguar mungesën e një marrëdhënieje varësie midis performancës së bankës dhe përmasat e bordit drejtues. Një aspekt tjetër i referohet përbërjes së bordit, në veçanti ndikimit të pranisë së femrës në bordin drejtues të bankave. Sipas Adams dhe Ferreira [17], bordet e drejtorëve janë më shumë efektive kur ata mund të kenë një numër më të madh individësh të talentuar dhe, në veçanti, më shumë prezencë të gjinisë femërore. Femrat kanë lehtësi më të madhe në menaxhimin e marrëdhënieve sesa burrat. Prania e femrave në borde drejtuese mund të çojë në një përmirësim të përgjithshëm në cilësinë e përgjithshme të organizimit dhe funksionimit të bordit. Megjithatë, sipas Eisenberg [20], rritja e diferencimit gjinor mund të çojë në reduktim të harmonisë brenda “ekipit” të drejtorëve, pasi ajo mund të ndikojë në besimin mes gjinive të anëtarëve të ndryshëm dhe gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar. Kjo do të rezultojë në nevojën për të zëvendësuar të gjithë besimin me mekanizma alternative të koordinimit të sjelljeve dhe vendimet, me një rritje të shpenzimeve organizative. Matic dhe Papac konstatojnë se rentabiliteti i bankave që operojnë në Serbi po zvogëlohet me rritjen e përqendrimit të pronësisë. Shumë studime gjithashtu hulumtojnë lidhjen midis llojit të pronësisë së bankës (të huaj, shtetit dhe private-vendore) dhe rentabilitetit bankar. Shumica e studimeve konstatojnë se bankat private janë më fitimprurëse sesa bankat shtetërore, ndërsa bankat e huaja janë më fitimprurëse sesa bankat

private vendase që veprojnë në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion.

Megjithatë, ka studime që kanë gjetur një lidhje negative midis pronësisë së huaj dhe përfitimit të bankave në ekonomitë në zhvillim [21]. Ato konstatojnë se pronësia e huaj është një faktor negativ i vlerës për bankat në tregjet në zhvillim për shkak të mungesës së motivimit dhe fuqisë negociuese të aksionerëve të huaj në krahasim me ato vendase. Ata gjithashtu konstatojnë se pronësia shtetërore ka një ndikim pozitiv në përfitimin e bankave në periudhën e krizës globale në tregjet në zhvillim, kryesisht për shkak të faktit që bankat në pronësi të qeverisë kanë qasje në përfitime të veçanta si subvencionimi i qeverisë dhe kreditë me normën e interesit më të ulët sesa tregu, i cili mund t'i ndihmojë ata që të mbijetojnë në kohën e krizës financiare. Ndryshe nga shumica e studimeve të mëparshme që kanë ndikim të fortë të tipit të pronësisë në profitabilitetin e bankave [22], studime të shumta kanë treguar se një bord me një përqindje të lartë të drejtorëve të pavarur mund të mbrojë interesat e aksionarëve të pakicave dhe të përmirësojë performancën e kompanive në ekonomi me mbrojtje të dobët ligjore të investitorëve [23]. Gjithashtu, studimet tregojnë se aksionerët e mëdhenj në bankat e Serbisë kanë tendencë të caktojnë borde të dobëta, të cilat mund të çojnë në konflikte serioze midis aksionerëve dominues dhe pakicë. Bazuar në rezultatet e studimeve mbi qeverisjen e korporatave në vendet në zhvillim me mbrojtje të dobët të investitorëve ne presim të gjejmë një marrëdhënie pozitive midis pavarësisë së bordit dhe performancës së bankës. Ka një korrelacion negativ ndërmjet BS dhe performancës së firmës [24].

Përfundime

Kriza financiare globale e viteve 2007-2009 theksoi domosdoshmërinë për reagim të menjëhershëm për forcimin e qeverisjes së korporatave në sektorin bankar. Ideja kryesore ku bazoheshin këto veprimeve ishte se mbikëqyrësit/rregullatorët duhet ta përdorin qeverisjen e korporatave nisur nga këndvështrimi i stabilitetit financiar. Siç u shpjegua më lart, qeverisja e korporatave konsiderohet si instrument plotësues në rregullimin bankar që ndihmon në ruajtjen e besimit të publikut në sistemin bankar, duke qenë thelbësor për stabilitetin financiar dhe për të gjithë ekonominë.

Një qeverisje e shëndoshë e korporatave dhe një rol i fortë i rregullatorit financiar kanë rëndësi tejet të madhe, pavarësisht fazës së zhvillimit të ekonomisë së një vendi. Ndonëse kriza financiare zbuloi se procesi i çrregullimit në vendet e zhvilluara nuk u shoqërua nga praktika të duhura të vetërregullimit në aspektin e qeverisjes së korporatave, të cilat duhej të inkurajoheshin nga forca të jashtme të tregut, vendet në tranzicion si Shqipëria hasin gjithashtu “hendeqe” të ngjashme, por me një natyrë dhe për shkaqe të tjera.

Referenca

1. Smerdon, J. E (2010). Climate model as a test bed for climate reconstruction methods. *Wiley Interdisciplinary Reviews Climate Change*, in revision, 2011, pp 134-135.
2. Arun, T. G., & Turner, J. D. (2004). Corporate governance of banks in Developing Economies: Concepts and issues. *Corporate Governance: An International Review*. Wiley Blackwell. Vol.12. No. 3. 371-377, pp 265-268.
3. OECD, (2003). White Paper on Corporate Governance in South East Europe, <http://www.oecd.org/dataoecd/9/21/20490351.pdf>, pp 25.
4. Barth, J., Caprio, G., & Levine, R., (2002), Bank regulation and supervision: what works best?, *Journal of Financial Intermediation*, 2004, vol. 13, issue 2, pp 205-248.
5. Shleifer, A. and Vishny, R. (1997). A survey

- of corporate governance. *The Journal Of Finance*, Vol. LII, No 2, pp 198-202.
6. EBA, (2011), EBA Guidelines on Internal Governance (GL 44), September 11, 2011, 3. Concept used in the Guidelines, Available at EBA, www.eba.europa.eu.
 7. Baker, K. H., Anderson, R., & Editors. (2010). *Corporate Governance: A synthesis of Theory, Research and Practice*. Hoboken, New Jersey: John Wiley & Sons, Inc, pp 205-209.
 8. Monks, A. G., & Minow, N. (2008). *Corporate Governance*, Southern Gate, Chichester: John Wiley & Sons, Inc, pp 153-155.
 9. Solomon, J. (2010). *Corporate Governance and Accountability*, Third Edition, pp 102-106.
 10. Stephen, F. and Backhaus, J. (2003). Corporate Governance and mass privatization – A theoretical investigation of transformations in legal and economic relationships. *Journal of Economic Studies*, Vol. 30, No. ¾, pp 167-171.
 11. Goodpaster, K. (1991), *Business Ethics and Stakeholder Analysis*, *Business Ethics Quarterly*. Vol. 1, No. 1 (Jan., 1991), pp. 53-73, Published by: Cambridge University Press.
 12. Kirkpatrick, G. (2009). *The Corporate Governance Lessons from Financial Crisis*, *Financial*, pp 181-183.
 13. Berger A. N., Clarke G. R. G., Cull R., Klapper L., & Udell G. F. (2005). Corporate governance and bank performance: A joint analysis of the static, selection and dynamic effects of domestic, foreign and state ownership. *Journal of Banking & Finance*. Vol. 29, pp 2179-2221.
 14. Mulbert, P. (2009). *Corporate Governance of banks after the financial crisis – Theory, Evidence, Reforms*, University of Mainz and ECGEI. Law Working Paper N0 130/2009, pp 145-147.
 15. Ciancianelli P, and J. Gonzales (2000). *Corporate Governance in Banking: A conceptual Framework*, Social Science Research Network Electronic Paper Collection: http://papers.ssrn.com/paper.tafaabstract_id=253714 on October 10th 2011, pp 216-219.
 16. Banca d' Italia (2007). "Supervisory Provisions concerning banks' organization and corporate governance," nr. 13, Italy, pp 54-57.
 17. Adams, R. B., & Ferreira, D. (2009). Women in the boardroom and their impact on governance and performance. *Journal of Financial Economics*, 94, pp 291-309.
 18. Belkhir, M. (2009). Board of directors' size and performance in the banking industry. *International Journal of Managerial Finance*, 5(2), pp 201-221.
 19. Mayur, M., & Saravanan, P. (2006). Does the board size really matter? An empirical investigation on the Indian banking sector. *Journal of Corporate Governance*, 5(2), pp 1-17.
 20. Eisenberg, T. (1998). Larger board size and decreasing firm value in small firms. *Journal of Financial Economics*, 48, pp 35-54.
 21. Ivashkovskaya, I., Ivantsova, O., & Stepanova, A. (2012, May 14–15). Corporate governance and strategic bank performance: International evidence, 9th Workshop on Corporate Governance, Brussels, Belgium, pp 189-195.
 22. Kořak, M. (2011). Ownership structure and performance of the banking sector: The evidence from Balkan countries. *Economic Research*, 24, pp 331–354.
 23. Dahya, J., Dimitrov, O., & McConnell, J. (2008). Dominant shareholder, corporate boards, and corporate value: A cross-country analysis. *Journal of Financial Economics*, 87, pp 73–100.
 24. Bektas, E., & Kaymak, T. (2009), Governance mechanisms and ownership in an emerging market: The case of Turkish banks. *Emerging Markets Finance and Trade*, 45, pp 20–32.



Viti i VII-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2016

UDHËZIME PËR AUTORËT

Materialet (artikujt) i adresohen revistës *OPTIME*. Ato i nënshtrohen vlerësimit të redaksisë, e cila miraton për botim, pasi ka bërë modifikimet eventuale.

Materiali i dërgohet sekretariatit të redaksisë së *Albanian University* në adresën *Bulevardi Zogu I, Tiranë, znj. Eglantina Dervishi, email: egladervishi@yahoo.com dhe Erda Qorri, email: erdaqorri@gmail.com*

Materiali dorëzohet në 3 kopje (një origjinal dhe 2 fotokopje), si dhe në formën elektronike (me disketë). Ai duhet të shoqërohet me adresën e email-it të autorit me të cilin do të lidhet redaksia në vazhdim. Po ashtu, dorëzohet një formular, i cili duhet të firmoset nga autorët e tjerë që i delegojnë autorit kryesor kompetencat. Autorësia nënkupton që secili autor të këtë marrë pjesë në mënyrë të mjaftueshme në punim, aq sa të marrë përgjegjësi publike për përmbajtjen e tij. Renditja e autorëve përcaktohet nga vendimi i përbashkët i bashkautorëve.

Pasi kthehet materiali për rregullime nga autori/autorët, ai ridërgohet në formën përfundimtare.

Drejtskrimi i gjuhës shqipe është i detyrueshëm. Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjës **ë** dhe **ç**, përkatësisht me shkronjat **e** dhe **c**.

Materiali duhet të renditet sipas kësaj mënyre:

Faqja e titullit përmban:

Titullin

Emrin /emrat e autorëve (pa titujt shkencorë)

Adresat e të gjithë autorëve. Kur autorët janë në qendra të ndryshme pune, djathtas tyre bëhet një shenjë (që specifikohet më poshtë), p.sh.:

Emër Mbiemër *, Emër Mbiemër **, Emër Mbiemër ***

* Albanin University

** Fakulteti i Mjekësisë i UT

*** Ministria e Shëndetësisë

Adresa e plotë (përfshirë telefonin dhe email-in) e autorit që do të mbajë lidhje me revistën.

Abstrakti

Paraqitet në shqip dhe në versionin anglisht dhe përmban jo më shumë se 250 fjalë. Abstraktit në anglisht i vihet edhe titulli. Në abstrakt paraqitet qëllimi, metodat, rezultatet dhe përfundimet.

Poshtë abstraktit shkruhen fjalët kyçe. P.sh.:

Fjalë Kyçe: revistë, artikull, psikologji.

Materiali

Gjatë shtjellimit të materialit çdo referencë, figurë dhe tabelë numërohet në shifra arabe me numër rendor sipas rendit që citohen në tekst. Kur janë më shumë se 2 referenca, ato ndahen me presje).

Nuk përdoren shkurtime të tjera përveç atyre që janë përdorur në abstrakt.

Falënderimet, nëse ka, shtypen në mbarim të tekstit, pas referencave.

Referencat

Referencat shënohen në tekst me numërorë arabe sipas rendit që citohen.

Referencat shtypen në fletë të veçanta nga teksti me hapësirë dyfishe sipas stilit *Vancouver* (International Committee of Medical Journal Editors Uniform requirements for manuscripts submitted to biomedical journals). Kur lista e autorëve përbëhet nga 1 deri në 7 vetë, citohen që të gjithë. Kur ajo përmban më shumë se 7 vetë, citohen vetëm 3 të parët dhe pas të tretit, shënohet fjala et al. (ose me shkurtimin shqip *e bp.*).

Referencat përshkruhen si më poshtë:

1. Referenca e artikujve periodikë

Autorët ,Titulli, Revista, viti, volumi, faqe, p.sh. :

(1) Quilici J., Gallo R. Physiopatologie des syndromes coronariens aigus. Ann Cardiol. Angeiol 2009;148;611-23.

2. Referenca e një libri

Autori. Titulli, Vendi i botimit, Shtëpia botuese, Viti i botimit.

P.sh.:

(2) Cohen J. Return extrasystoles. New York; Grune and Stratton; 1996.

3. Referenca e një kapitulli libri

Autori kapitullit. Emri kapitullit. Emri i autorit të librit Emri i librit. Vendi i botimit. Shtëpia botuese. Viti botimit; faqet e kapitullit.

P.sh.:

(3) Baillet J. L'apport de la scintigraphie dans le diagnostic de l'embolie pulmonaire. Në: Chiche P La maladie thrombo-embolique pulmonaire Paris; L'Expansion scientifique française; 1969, f. 107-34.

Shkrimet që nuk u përmbahen këtyre udhëzimeve do t'u rikthehen autorëve për rishikim pa u marrë në shqyrtim.

Redaksia